



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 21.12.2022

**Lënda:** Parashtrimet të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 21.12.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 264/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik, vlerësoi parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 21.11.2022, administruar në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 5.12.2022, dhe analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, përcjellë me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 15.12.2022, për secilin shkak ankimi.

Komisioneri Publik, fillimisht sjell në vëmendjen e Kolegjit, se pas shqyrtimit të *analizës paraprake*, të kryer nga Kolegji, vëren se, në disa prej tabelave pjesë e saj në kolonën “*sipas Komisionerit Publik*”, disa zëra të pasqyruara në kolonën përkatëse, kërkojmë mos të referohen si kërkime të Komisionerit Publik në ankimin e datës 5.10.2020 dhe të parashtrimeve të paraqitura në Kolegji, në seancën gjyqësore publike të datës 5.12.2022.

Vlerësimi i Komisionerit Publik në lidhje me aktin e përcjellë nga Kolegji, gjen pasqyrim përsa do të trajtohet në vijim:

**Për vlerësimin e kriterit të pasurisë**

1. *Lidhur me shkakun ankimor: verifikimi i mundësisë financiare të babait të subjektit \*\*\*,\*\* për dhurimin e shumës 6.000 euro dhe 4.000 usd, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit dhe pretendimet e*

subjektit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, vlerëson se:

1.1 Komisioneri Publik, sikundër ka theksuar dhe në ankim, vlerëson se për sa kohë që si një nga burimet e blerjes së pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, deklarohen dy depozitat bankare në emër të të atit z.\*\*\*.\*\*\*, analiza financiare duhet të kryhet për vlerësimin e mundësisë financiare të z.\*\*\*.\*\*\* deri në momentin e krijimit të këtyre depozitave, shkurt 2005-nëntor 2008. Krahas këtij argumenti, lidhur me analizën e kësaj periudhe dhe zërat përbërës të saj<sup>1</sup>, vlerësohet si më poshtë:

- Rezulton se në zërin “Të ardhura” është përfshirë zëri: *Likuiditete nga Bonot e Thesarit* në vlerën 630.000 lekë. Nga verifikimi i akteve në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit, pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konkretisht në përgjigje të pyetësorëve 4<sup>2</sup> dhe 6<sup>3</sup> të Komisionit, ka deklaruar se shuma e tërhequr nga i ati në korrik 2005, nga investimi në bono thesari, ka shërbyer për shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit \*\*\*.\*\*\* Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në këto deklarime, kjo shumë duhet të reflektohet dhe në shpenzimet e periudhës së analizuar;
- Komisioneri Publik gjen të pambështetur pretendimin e subjektit mbi të ardhurat nga qiraja në vlerën 220.000 lekë, nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, për sa kohë që nuk rezulton e provuar se ky shtetas ka personalitetin juridik të personit fizik, duke mbartur edhe detyrimin për pagesën e tatimit, kjo shumë duhet të hiqet nga të ardhurat;
- Shpenzimet e jetesës, në vlerësimin e Komisionerit Publik duhet të llogariten sipas standartit të përcaktuar nga INSTAT, përdorur në jurisprudencat e deritanishme të Kolegjit për subjektet e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me ta;

1.2 Marrë në konsideratë sa më lart, nga analiza financiare e personit tjetër të lidhur për periudhën shkurt 2005 - nëntor 2008, do të rezultonte pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur për mbulimin me burime të ligjshme të shumave të dhuruara për një diferencë negative prej – 736.516 lekë.

2. *Lidhur me shkakun ankimor:* Dhurimet e personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për fëmijët e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2008-2016, shumën totale prej 950.000 lekë, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të pranuar në cilësinë e provës me vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, në seancën

<sup>1</sup> Referuar tabelës nr.1 fq.2 e analizës paraprake të Kolegjit.

<sup>2</sup> Në përgjigje të pyetjes nr.1, nënpyetjes i, të Komisionit subjekti përgjigjet: *Destinacioni i shumës 630.000 lekë në llogarinë dyemërore me babain, që u tërhoq në korrik pas maturimit/kthimit të investimit në bono thesari, u përdor nga babai për shlyerjen në këste të huasë që kishte marrë nga \*\*\* në janar 2005 për plotësimin e pagesës së këstit të tretë të apartamentit marrë \*\*\*.\*\*\*.*

<sup>3</sup> Në përgjigje të pyetjes nr.3 të Komisionit, subjekti përgjigjet: *“Si dhe kam deklaruar në përgjigje të pyetjes 1 të pyetësorit 4, për blerjen e apartamentit të tij, në rrugën “\*\*\* \*\*\*” (pranë \*\*\* \*\*\*) babai i ka marrë \*\*\*.\*\*\* një "hua në shumën 2.140.000 lekë, pa marrëdhënie kontraktore dhe pa interes, me garant \*\*\*, për vetë lidhjen miqësore të tyre... Nga llogaria e përbashkët në bono thesari, dyemërore e inja me babain, shuma totale (principal + interesa) prej 630'000 lekë e tërhequr në qershor-korrik 2005, u mbajt e gjitha nga babai im, që të shërbente për përmbushjen e pjesës së këtij detyrimi, pasi pjesa tjetër do të përmbushej ndër vite nga kursimet që ai do të realizonte (pension + qira). Ndërkohë, pavarësisht se kontribut i kujt ishte sipas rastit, herë i vetë babait dhe herë nga të ardhurat tona (të miat e të bashkëshortit), pasi në atë periudhë ishin të konsiderueshme dhe se ne nuk kishim asnjë shpenzim a detyrim tjetër përveç atyre periodike normale të familjes sonë - shiko të ardhurat në vitet 2005-2009, jemi munduar që të bëjmë pagesa në shuma të ndryshme në favor të \*\*\*.\*\*\*, dhe në maj të vitit 2009 është likuiduar e plotë shuma e huasë prej 2.140.000 leke, sikurse vërtetohet dhe në deklaratën noteriale nr.\*\*\* rep.,nr \*\*\* kol., datë \*\*.11.2011 notere \*\*\*.\*\*\*.*

gjyqësore publike të datës 5.12.2022, rezultojnë rrethana që dëshmojnë një marrëdhënie të ngushtë e karakterit familjar të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\* me z. \*\*\*.\*\*\*, me rrjedhoja krijimin e depozitave pranë \*\*\*-së, duke u çmuar se plotësohen nevojat e hetimit për këtë shkak ankimi.

3. *Lidhur me shkakun ankimor* për vlerësimin e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, për t'i dhënë hua personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumën totale 45.000 euro në vitin 2009, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, konstaton se:

3.1 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet dhe shpjegimet e datës 17.11.2022, ndër të tjera, ka parashtruar lidhur se: *“anëtarët e familjes së “Personit tjetër të lidhur” z.\*\*\*.\*\*\*, konkretisht z.\*\*\*, znj.\*\*\*, znj.\*\*\*.\*\*\* dhe dy fëmijët e mitur nuk kanë patur asnjë detyrim ligjor në kuptim të nenit 3 pika 14 dhe nenit 32 pika 4 të ligjit 84/2016 për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tyre, pasi nuk plotësojnë krieteret ligjore për t'u konsideruar persona të tjerë të lidhur”*<sup>4</sup> Për këtë fakt ka kërkuar: *“Në vështrim të nenit 32 pika 4 e ligjit 84/2016 kam detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të asaj pasurie deri në vlerën e huasë pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë “personat e tjerë të lidhur” me “personin tjetër të lidhur” z.\*\*\*.\*\*\**<sup>5</sup>.

3.2 Për kontratat e qirasë të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, që datojnë respektivisht në vitet 1996, 1999, 2000 dhe 2001<sup>6</sup>, subjekti në parashtrimet e saj ka pretenduar që të ardhurat nga marrëdhëniet e përfitura nga këto kontrata qeraje për dhënien me qera të një objekti në qytetin e Tiranës, të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

3.2.1 Komisioneri Publik, konstaton se vetëm në kontratën e qerasë datë \*\*6.1996 z.\*\*\*.\*\*\*, babai i personit tjetër të lidhur, është në cilësinë e qiradhënësit dhe do të përfitojë ½ nga shuma prej 590 usd e objektit të dhënë me qera sipas kësaj kontrate, me afat 6 muaj. Për kontratat e qerasë në vitet 1999, 2000 dhe 2001 ku në cilësinë e qiradhënësit është vetëm z. \*\*\*.\*\*\* (bashkëpronari tjetër me 1/2 pjesë), subjekti argumenton në prapësimet e saj datë 17.11.2022, që në kuptim të nenit 200 të Kodit Civil, z.\*\*\*.\*\*\* ka të drejtë të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjestim me pjesën e tij.

3.2.2 Komisioneri Publik konstaton si pjesë e akteve të praktikës së rregjistrimit të pasurisë së llojit ndërtesë, nr. pasurie \*\*\*-ND vol.\*\*, fq.\*\*\*, zk.\*\*\* me sipërfaqe 882 m<sup>2</sup>, Tiranë (magazina \*\*\* \*\*\*, Tiranë), të përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2019 nga AShK Tirana Jug, edhe Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2012-\*\*\* (\*\*\*) datë \*\*.7.2012 me paditës të k/paditur \*\*\*.\*\*\* etj dhe të paditur \*\*\*.\*\*\* etj. me objekt pavlefshmëri e veprimi juridik të kontratës së shitjes datë \*\*.6.2003 dhe kthim të fryteve civile të sendit. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se prej datës \*\*.07.1996 objekti në fjalë i është dhuruar nga z. \*\*\*.\*\*\*, bashkëpronarit tjetër \*\*\*. Kontrata në fjalë e dhurimit është deklaruar e pavlefshme me një vendim gjyqësor të formës së prerë datë \*\*.05.2004. Pas marrjes së formës së prerë të vendimit gjyqësor, është ngritur një tjetër padi rivendikimi, si dhe për konstatimin e pavlefshmërisë së veprimeve të mëpashme juridike lidhur me pronësinë, duke u kërkuar edhe frytet civile të sendit. Përfundimisht, këto kërkime gjyqësore janë zgjidhur me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së

<sup>4</sup> Referojuni fq13.pgfi i katërt i prapësimeve e shpjegimeve të subjektit datë 17.11.2022.

<sup>5</sup> Referojuni fq14.pgfi i fundit i prapësimeve e shpjegimeve të subjektit datë 17.11.2022.

<sup>6</sup> Kopje kontratë qeraje \*\*\*/\*\*\* datë \*\*.6.1996 ku z. \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* janë në cilësinë e qiradhënësit dhe përfitojnë ½ secili; Kopje kontratë qeraje datë \*\*.8.1999 ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit; Kopje kontratë qeraje \*\*\*/\*\*\* datë \*\*.5.2000 ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit; Kopje kontratë qiraje \*\*\*/\*\*\* datë \*\*.12.2001 ku z. \*\*\*.\*\*\* është në cilësinë e qiradhënësit;

Lartë nr.00-2012-\*\*\* (\*\*\*) datë \*\*7.2012, duke detyruar mes të tjerash trashëgimtarët e bashkëpronarit tjetër, t'u paguajnë trashëgimtarëve të z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e fryteve civile të sendit, shumën prej 6.122.000 lekë që përfaqëson ½ e vlerës së përdorimit të sendit (magazinë) nga data e ngritjes së padisë \*\*11.2005 deri në ditën e gjykimit në Gjykatën e Apelit (\*\*04.2009). Nga lëvizjet e llogarisë bankare pranë \*\*\* Bank të z. \*\*\*.\*\*\*, rezulton se frytet civile (të ardhurat për përdorimin e sendit), për shkak të ekzekutimit të këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, janë kryer në datat 20.11.2012, 4.12.2013 dhe 10.12.2013, kohë pas dhënies së huasë, objekt i analizës.

3.3 *Lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur \*\*\*.\*\*\*, të pretenduara nga dhënia me qira e objektit, banesë të ndodhur mbrapa \*\*\* \*\*\* marrë, me qira nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* për periudhën 1996-2008 dhe të ardhurat e përfitura nga objekti (dyqan) me adresë në rr. "\*\*\*\* \*\*", marrë me qira nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1995-2012, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit në Kolegj ka paraqitur deklaratat noteriale<sup>7</sup> nga qiramarrësit. Për këto marrëdhënie qiraje, subjekti në prapësimet datë 17.11.2022, ka pretenduar njohjen si të ardhura të ligjshme edhe të ardhurat nga këto dy marrëdhënie qiraje, me pretendimin se, në të gjitha rastet e qirave të pronave të tyre, detyrimin për të paguar tatimin në burim në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, e kishin qiramarrësit, të cilët ushtronin aktivitetin në to.*

3.3.1 Komisioneri Publik konstaton se, referuar pretendimit të pasqyruar në prapësimet dhe shpjegimet e datës 17.11.2022, se të ardhurat nga qiraja e pronave duhet të konsiderohen si të ligjshme, edhe në eventualitetin e marrjes si të mirëqënë të ekzistencës së këtyre marrëdhënieve dhe të ardhurave të përfituara nga to, nuk është shpjeguar apo paraqitur dokumentacioni ligjor, mbi personalitetin juridik të qiramarrësve. Në këtë rast, nuk rezulton se janë paraqitur akte për justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga këto marrëdhënie, ashtu siç është vepruar me paraqitjen në Komision të shkresës së DRT, Tiranë, nr. \*\*\* prot., datë \*\*10.2019, për justifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të *personit tjetër të lidhur*, përfituar nga kontrata e qirasë me z. \*\*\*.\*\*\* në vlerën 680.000 lekë (2006-2009).

3.3.2 Përsa më sipër, dhe bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>8</sup>, të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga këto marrëdhënie qiraje duket se nuk përmbushin kriterin e konsiderimit të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

3.4 *Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i z.\*\*\*.\*\*\*, subjekti i rivlerësimit në prapësimet dhe shpjegimet e datës 17.11.2022 ka pretenduar se fitimi për vitet 1994-2008 duhet të llogaritet në masën 50%<sup>9</sup>, të cilat në analizën paraprake të kryer nga Kolegji në kolonën sipas pretendimeve të subjektit, rezulton e marrë në konsideratë në vlerën 6.362.533 lekë, kundrejt llogaritjes nga Komisioni me marzh fitimi 20% në vlerën 2.885.013 lekë. Komisioneri Publik, në mungesë, si të paraqitjes së akteve justifikuese nga ana e subjektit mbi fitimin e pretenduar në masën 50% të qarkullimit vjetor, ashtu edhe të dhënave të konfirmuara mbi marzhin e fitimit të aktivitetit tregtar të personit tjetër të lidhur, i referohet standartit të mbajtur nga ana e Komisionit e të pranuar në vendimin e konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me llogaritjen e marzhit të fitimit në masën 20% të qarkullimit vjetor, ç'ka do të rezultonte në pamjaftueshmëri financiare të personit tjetër të lidhur \*\*\*.\*\*\* për të mbuluar me të ardhura të ligjshme huanë e deklaruar dhënë bashkëshortit të subjektit.*

<sup>7</sup> Deklaratë noteriale \*\*\* datë \*\*1.2021 e z. \*\*\*.\*\*\* që ka banuar me qira në banesën e shtetasit \*\*\*.\*\*\* (1996-2008); Deklaratë noteriale \*\*\* datë \*\*1.2021 e z. \*\*\*.\*\*\* që ka marrë me qira një dyqan në pronësi të znj. \*\*\*.\*\*\* (1995-2012);

<sup>8</sup> Referoju vendimit (JR) 33/2022 të KPA.

<sup>9</sup> Referoju fq.19 të prapësimeve e shpjegimeve të subjektit datë 17.11.2022.

4. *Lidhur me shkakun ankimor* mbi kryerjen e analizës financiare për vlerësimin e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*.\*\*\*, që kanë shërbyer si burim për blerjen e Pasurisë nr. 2, “Vend parkimi (garazh), ndodhur në rruga e \*\*\*, Tiranë si dhe dhurimet e deklaruara ndër vite në total në vlerën 3.357.960 lekë, *Komisioneri Publik*, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, konstaton se:

4.1 Vlerësohet e drejtë përfshirja në burimet e ligjshme të familjes Toro, të të ardhurave nga qiratë bazuar në pretendimet dhe aktet shtesë të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, si dhe të shpenzimeve të blerjes së pasurive për periudhën e analizuar, konkretisht të apartamentit në vitin 2003 dhe atij në vitin 2007. Komisioneri Publik, vlerëson se, pas analizimit të akteve të depozituara nga subjekti mbi investimet e familjes Toro, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka provuar burimet e ligjshme të dhuruesve (familjes Toro) për të dhuruar shumat e deklaruara për periudhën 2010-2016.

5. *Lidhur me shkakun ankimor*: kryerjen e analizës financiare për subjektin e rivlerësimit për periudhën e deklarimit, *Komisioneri Publik*, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit, lidhur me këtë shkak ankimi dhe nga analizimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, vlerëson se:

5.1 Lidhur me zërin *Të ardhura Paga b/shorti*<sup>10</sup>, vlerësohet se kjo e ardhur do të mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme të analizës financiare, në ato raste kur provohet nga subjekti i rivlerësimit se e ardhura nga paga është përfituar/tërhequr. Rezulton se shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*.6.2017 i ISSH, referon të ardhurat e deklaruara për efekt të sigurimeve shoqërore e shëndetësore si i vetëpunësuar, për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Nga aktet në dosje të Komisionit, nuk rezulton të provohet se këto të ardhura janë kontabilizuar në zërin shpenzime të periudhës (sipas bilanceve të depozituara në dosje për vitet 2011 dhe 2012<sup>11</sup>). Nga verifikimi i llogarive personale të personit tjetër të lidhur, evidentohen vetëm dy transaksione, në datën \*\*.2.2014, kreditim i shumës 100.000 lekë me përshkrimin: \*\*\*.\*\*\* *P.Fizik, paga* si dhe datë \*\*.7.2015, kreditim i shumës 80.000 lekë me përshkrimin: \*\*\*.\*\*\* *P.Fizik për \*\*\*.\*\*\* kalime pagash*. Në këto kushte, në vlerësimin e Komisionerit Publik, përveç dy shumave të mësipërme të evidentuara për vitet 2014 dhe 2015, në të ardhurat vjetore për bashkëshortin duhen marrë në konsideratë, vetëm të ardhurat e deklaruara si fitim neto vjetor i aktivitetit, të konfirmuara edhe nga organet tatimore<sup>12</sup> të reflektuara në zërin: *Të ardhura nga Avokatia (fitime)* të Tabelës nr.5 të analizës paraprake.

5.2 Lidhur me zërin: *Huamarrje \*\*\*.\*\*\**, konstatohet se, për vitin 2012, shlyerja e detyrimit ndaj huadhënësit është llogaritur në analizën paraprake financiare në vlerën 418.770 lekë, si kundërvlerë e shumës 3.000 euro, deklaruar nga ana e subjektit në përgjigje të pyetësit nr.2 të Komisionit gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që në DV-2012 subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 5.000 euro ndaj huadhënësit \*\*\*.\*\*\* ose 697.950 lekë, pagesë e cila do të ndikonte në thellimin e diferencës negative të vitit 2012 midis të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe

<sup>10</sup> Kolegji ndryshe nga Komisioni, ka reflektuar në këtë zë të ardhurat sipas shkresës nr. \*\*\* prot., date \*\*.06.2017, dosja ILDKPI.

<sup>11</sup>Nga pasqyrat financiare të vitit 2012, në zërin “Shpenzime personeli”, shpenzimet për “Pagat” janë zero, ndërkohë që janë pasyruar shpenzimet për “Siguracion”.

<sup>12</sup> Qëndrim ky mbajtur edhe në vendimin e Kolegjit (JR) 27/2019.

personave të lidhur me të. Edhe në konsideratë të përfshirjes në analizë të shumës 418.770 lekë, përsëri për vitin 2012 do të rezultonte se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e këtij viti.

- Lidhur me zërin: *Shpenzime udhëtimi*, nga vlerësimi i akteve të depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, vlerësohet se në analizën financiare duhet të merren në konsideratë vetëm kostot e udhëtimit të konfirmuara nga agjensitë e udhëtimit, të lexuara këto në harmoni edhe me deklaratimet e subjektit, në përgjigjet e pyetësorit nr.1 të Komisionit. Në mënyrë të detajuar, lutemi referojuni Aneksit të këtyre parashtrimeve, bazuar në konkluzionet e të cilit rezulton se konkretisht (i) *shpenzimet e udhëtimeve të vitit 2012 vlerësohen në shumën 348.675 lekë*; (ii) *shpenzimet e udhëtimeve të vitit 2014 vlerësohen në shumën 539.584 lekë*; (iii) *shpenzimet e udhëtimeve të vitit 2015 vlerësohen në shumën 422.548 lekë*; (iv) *shpenzimet e udhëtimeve të vitit 2016 vlerësohen në shumën 777.573 lekë*<sup>13</sup>.

5.3 Në lidhje me pretendimin e subjektit mbi disponimin në vitin 2012 të shumës 1.000 euro cash, si diferencë e mbetur nga dhurimi shumës 10.000 euro një viti më parë nga babai i bashkëshortit<sup>14</sup>, Komisioneri Publik, në referencë edhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>15</sup> mbi deklarinimin e likuiditeteve Cash jashtë sistemit bankar, e gjen të pabazuar këtë pretendim, në mungesë të deklarinimit të këtyre kursimeve në DV-në përkatëse.

5.4 Bazuar në sa më sipër vlerësuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet e vitit 2012 për një diferencë negative prej *-991.690 lekë*, shpenzimet e vitit 2014 për një diferencë negative prej *-172.624 lekë*, shpenzimet e vitit 2015 për një diferencë negative prej *-303.853 lekë* dhe shpenzimet e vitit 2016 për një diferencë prej *-216.658 lekë*.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>13</sup> Në DV-2016 subjekti ka deklaruar “Shpenzime për pushime në Greqi dhe udhëtim në Gjermani – Itali, dy deri në katër ditë, në total 5.500 euro”.

<sup>14</sup> Referuar paragrafit të parë në faqen 30 të parashtrimeve

<sup>15</sup> (JR) nr. 11/2019; (JR) nr. 19/2019; (JR) nr. 20/2019; (JR) 7/2019, (JR) 27/2020.

## Aneks 1

### - *Në analizën financiare të vitit 2012, shpenzimet e udhëtimeve janë llogaritur si më poshtë vijon:*

- 5.4.1 Mbi udhëtimin e datave \*\*.07.2012 – \*\*.08.2012, deklaruar udhëtim me familjen në Firenze me traget dhe makinë, bazuar edhe në deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1, vlerësojmë të drejtë llogaritjen nga ana e Kolegjit, bazuar në metodologjinë e tij, në shumën 906 euro/126.587 lekë.
- 5.4.2 Mbi udhëtimin e datave \*\*.08.2012 – \*\*.08.2012, deklaruar udhëtim me familjen në Turqi, vlerësojmë të konsiderohet në shumën e konfirmuar nga agjensia \*\*\* \*\*\*, sipas aktit të paraqitur mbi kostot e pushimeve në shumën 600 euro/83.754 lekë<sup>16</sup>.
- 5.4.3 Mbi udhëtimin e datës \*\*.09.2012, deklaruar nga subjekti në pyetësorin nr.1 *udhëtim me familjen në Maqedoni disa orësh*, vlerësojmë të drejtë llogaritjen dhe përfshirjen e kostos 35 euro/4.886 lekë, bazuar në pretendimet e subjektit.
- 5.4.4 Mbi udhëtimin e datave \*\*.10.2012 – \*\*.10.2012, deklaruar nga subjekti në pyetësorin nr.1 *udhëtim në Mal të Zi*, konfirmuar nga agjensia e udhëtimit \*\*\* \*\*\* në shumën 110 euro, vlerësojmë se duhet të merret në konsideratë pretendimi i subjektit sipas aktit të paraqitur për këtë kosto të konfirmuar, duke i shtuar dhe shpenzimet për automjetin me të cilin ka udhëtuar, referuar kostos së llogaritur nga Kolegji, që do të rezultonte në total shumën 196 euro/27.360 lekë.
- 5.4.5 Mbi udhëtimin e datave \*\*.11.2012-\*\*.11.2012, deklaruar nga subjekti si udhëtim i kryer së bashku me bashkëshortin në Pragë dhe Vjenë, vlerësojmë të drejtë llogaritjen bazuar në metodologjinë e Kolegjit, në shumën 600 euro/83.754 lekë. Pretendimet dhe aktet e depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, vlerësohen se gjenden të pabazuara dhe nuk përputhen me deklaratimin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1<sup>17</sup> të Komisionit. Gjithashtu, nuk rezultoi i deklaruar mbulimi i këtij udhëtimi nga ky shtetas as në DV-2012, në seksionin “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, përkundër detyrimit që ka pasur subjekti në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.
- 5.4.6 Mbi udhëtimin e datave \*\*.11.2012 – \*\*.11.2012, vlerësohet se gjendet i mbështetur pretendimi i subjektit për kostot e udhëtimit në vletën 160 euro/22.334 lekë, mbështetur në vërtetimin e datës \*\*.09.2019 nga shoqëria e udhëtimit \*\*\* \*\*\*.

### - *Në analizën financiare të vitit 2014, shpenzimet e udhëtimeve janë llogaritur si më poshtë vijon:*

- 5.4.7 Mbi udhëtimin e datave \*\*.01.2014 – \*\*.01.2014, deklaruar nga subjekti udhëtim me familjen në Strugë, vlerësojmë të drejtë llogaritjen, bazuar në metodologjinë e Kolegjit, në

<sup>16</sup> Është konsideruar konfirmimi nga shoqëria, edhe pse në pyetësorin nr.1 subjekti ka deklaruar se, për këtë udhëtim, e bija ka paguar ½ e kostos së biletës.

<sup>17</sup> Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr.1 mbi udhëtimet dhe dhuratat.

shumën 240 euro/33.593 lekë. Pretendimet dhe aktet e depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, vlerësohen se gjenden të pabazuara dhe nuk përputhen me deklarin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1<sup>18</sup> të Komisionit. Gjithashtu, nuk rezulton i deklaruar mbulimi i këtij udhëtimi nga ky shtetas as në DV-2014, në seksionin “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, përkundër detyrimit që ka pasur subjekti në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

5.4.8 Mbi udhëtimin e bashkëshortit të subjektit në datën \*\*.01.2014 – \*\*.01.2014, vlerësojmë të drejtë llogaritjen, bazuar në metodologjinë e Kolegjit, në shumën 205 euro/28.694 lekë. Pretendimet dhe aktet e depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, vlerësohen se gjenden të pabazuara dhe nuk përputhen me deklarin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1<sup>19</sup> të Komisionit. Gjithashtu, nuk rezulton i deklaruar mbulimi i këtij udhëtimi nga ky shtetas as në DV-2014, në seksionin “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, përkundër detyrimit që ka pasur subjekti në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

5.4.9 Mbi udhëtimin e datave \*\*.08.2014 – \*\*.09.2014, vlerësojmë të drejtë llogaritjen e kostos së udhëtimit sipas deklarin të subjektit në vlerën 2.600 euro/363.922 lekë.

5.4.10 Mbi udhëtimin e datave \*\*.11.2014 – \*\*.12.2014, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me bashkëshortin (Rinas-Venecia-Paris), vlerësojmë të drejtë llogaritjen, bazuar në metodologjinë e Kolegjit, në shumën 760 euro/106.506 lekë. Pretendimet dhe aktet e depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, se shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, vlerësohen se gjenden të pabazuara dhe nuk përputhen me deklarin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1<sup>20</sup> të Komisionit, si dhe nuk rezulton i deklaruar mbulimi i këtij udhëtimi nga ky shtetas as në DV-2014, në seksionin “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, përkundër detyrimit që ka pasur subjekti në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

5.4.11 Mbi udhëtimin e datës \*\*.12.2014 – \*\*.12.2014, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me bashkëshortin për disa orë në Mal të Zi, vlerësojmë të drejtë përllogaritjen, bazuar në metodologjinë e Kolegjit, në shumën 50 euro/6.999 lekë. Nuk rezulton të jenë përfshirë këtu kostot e udhëtimit.

- ***Në analizën financiare të vitit 2015, shpenzimet e udhëtimeve janë llogaritur si mëposhtë vijon:***

5.4.12 Mbi udhëtimin e datave \*\*.05.2015 – \*\*.05.2015, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me familjen në Greqi, vlerësojmë të drejtë se shpenzimet e udhëtimit, të llogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit, janë 413 euro/56.697 lekë. Pretendimet e subjektit mbi kostot e këtij udhëtimi në shumën 375 euro, nuk mbështeten në akte provuese.

5.4.13 Mbi udhëtimin e datave \*\*.06.2015 – \*\*.06.2015, deklaruar udhëtim i kryer nga bashkëshorti i subjektit, vlerësojmë se, bazuar dhe në deklarin e subjektit në pyetësorin nr. 1, ku subjekti ka deklaruar vetëm akomodimin në banesën e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, gjendet i mbështetur pretendimi i subjektit vetëm përsa i përket rishikimit të kostove të akomodimit dhe jo mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit, të cilat, për këtë rast, nuk rezultojnë të deklaruara as

<sup>18</sup> Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr.1 mbi udhëtimet dhe dhuratat.

<sup>19</sup> Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr.1 mbi udhëtimet dhe dhuratat.

<sup>20</sup> Referuar përgjigjeve të pyetësorit nr.1 mbi udhëtimet dhe dhuratat.



në përgjigje të pyetësorit nr.1 dhe as në DV-2014, në seksionin “*dhurata dhe trajtime preferenciale*”, përkundër detyrimit që ka pasur subjekti në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Si rrjedhim, shpenzimet e këtij udhëtimit do të rezultojnë në shumën 165 euro/22.651 lekë.

5.4.14 Mbi udhëtimin e datave \*\*.08.2015 – \*\*.09.2015, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me familjen në Firenze, Itali, vlerësojmë të drejtë përfshirjen në kostot e udhëtimit të shumës 2.500 euro/343.200 lekë, referuar edhe deklaratimeve të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2015.

- ***Në analizën financiare të vitit 2012, shpenzimet e udhëtimeve janë llogaritur si më poshtë vijon:***

5.4.15 Mbi udhëtimin e datave \*\*.03.2016 – \*\*.03.2016, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me familjen në Berlin, vlerësojmë të drejtë përfshirjen në kostot e udhëtimit të shumës 1.350 euro/182.561 lekë, referuar edhe deklaratimeve të subjektit.

5.4.16 Mbi udhëtimin e datave \*\*.03.2016 – \*\*.03.2016, deklaruar nga subjekti se ka udhëtuar me familjen në Itali dhe akomoduar tek të afërm, vlerësojmë të mbështetur pretendimin e subjektit dhe llogaritjen e kostove të akomodimit në shumën 5 euro dita/person<sup>21</sup> dhe llogaritjen e kostove të udhëtimit sipas metodologjisë së Kolegjit, duke rezultuar shpenzimi në shumën 435 euro/58.825 lekë.

5.4.17 Mbi udhëtimin e datave \*\*.04.2016 – \*\*.04.2016, deklaruar nga subjekti se ka shoqëruar bashkëshortin në udhëtimin në Mynih, vlerësojmë të përfshihet në kostot e udhëtimit shuma 550 euro/74.377 lekë, referuar deklaratimit të subjektit.

5.4.18 Mbi udhëtimin e datave \*\*.08.2016 – \*\*.09.2016, deklaruar nga subjekti udhëtim familjar për pushime, vlerësojmë të përfshihet në kostot e udhëtimit shuma 1.800 euro/243.414 lekë, referuar deklaratimit të subjektit.

5.4.19 Mbi udhëtimin e datave \*\*.09.2016 – \*\*.09.2016, deklaruar nga subjekti udhëtim familjar dhe fjetje Mal i Zi, Plavë-Guci, vlerësojmë se kostot e këtij udhëtimit duhet të llogariten për 4 persona bazuar në metodologjinë e Kolegjit, referuar kjo dhe deklaratimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr.1, në vlerën 215 euro/29.074 lekë.

5.4.20 Mbi udhëtimin e datave \*\*.11.2016- \*\*.11.2016 deklaruar nga subjekti udhëtim familjar në Itali, vlerësojmë të përfshihet në kostot e udhëtimit shuma 1.400 euro/189.322 lekë, referuar deklaratimit të subjektit.

---

<sup>21</sup> Rezultojnë se akomodimin pranë të afërmeve, për të cilët ka paraqitur dhe akte gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti e ka deklaruar edhe në përgjigje të pyetësorit nr.1 të Komisionit.